



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.381/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Llazić, Afjete Sada – Gllogjani, Kymete Kicaj, Zyhdi Haziri, Rustem Thaqi, Ferki Xhaferi, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për verifikim dhe numërim të 1,806 pakove të fletëvotimeve të dorëzuara me postë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli i paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.381/2019 e datës 02.11.2019, me të cilin ka kërkuar të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për verifikim dhe numërim të 1806 (njëmijë e tetëqind e gjashtë), pako me fletëvotime, të dorëzuar në post nga qytetarët (votuesit) jashtë vendit, brenda afatit ligjor të publikuar nga KQZ.

A r s y e t i m

Me datën 02.11.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.381/2019, të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën thekson se me datë 01 nëntor 2019, rreth orës 17:00, në QNR, gjatë numërimit të 4,639 pakove me fletëvotime, kanë vërejtur se 1,806 pako me fletëvotime, nuk janë dërguar nga Sekretariati i KQZ-së, në KQZ, për verifikim dhe numërim, me arsyetim kundër kushtetues dhe ligjor, dhe me pretendimin se këto fletëvotime kanë arritur në KQZ, me datë 17 tetor 2019, pavarësisht se data e dorëzimit të atyre fletëvotimeve është në përputhje me afatet ligjore të publikuara nga KQZ, kështu që sipas parashtruesit të ankesës ky veprim i Sekretariatit të KQZ-së, është veprim kundër kushtetues, kundërligjor, dhe në kundërshtim me Aktgjykimin A-A.U.ZH.nr.20/2019, të Gjykatës Supreme. Më tutje parashtruesi në ankesë kërkon nga PZAP-i, se meqenëse këto pako me fletëvotime të cekura më lartë, janë dorëzuar me postë në afatin ligjor të publikuar nga KQZ, si dhe duke marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A-A.U.ZH.nr.20/2019, të merr vendim që të urdhëroj KQZ-në, për verifikim dhe numërim të 1,806 pakove të fletëvotimeve të dorëzuara me postë nga qytetarët të cilët jetojnë jashtë vendit, brenda afatit ligjor të publikuar nga KQZ.

Në përgjigje në ankesë të datës 02.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thekson se Sekretariati i KQZ-së, ka bërë verifikimin e pakove me fletëvotime për 4,639 pako me fletëvotime, të cilat nga vlerësimi i këtyre pakove ka rezultuar se: 5,882 pako me fletëvotime janë vlerësuar si të individualizuara (pakot e vlerësuara me fletëvotime si të individualizuara, ka rezultuar se brenda një pakoje ka mund të jenë me shumë se një fletëvotim). Nga këto 5,882 pako me fletëvotime të vlerësuara si të individualizuara, 4,670 pako janë aprovuar, të cilat u janë dërguar Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për numërim, ndërsa 1,212 pako me fletëvotime të individualizuar janë refuzuar.

Gjithashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton, se me datën 17.10.2019 nga posta numër 6, kutia postare 351, në Prishtinë, ka tërhequr 1,806 pako të supozuara me fletëvotime, e cila shifër nuk përmendet në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, i datës 30.10.2019. Arsye e tërheqjes së këtyre pakove nga kjo postë, para se gjithash ka të bëjë edhe për arsye logjistike të hapësirës së postës dhe gjithashtu, për shkak të segmentit të mbrojtjes së të dhënave personale që përmbajnë këto zarfe. Pra, këto pako me fletëvotime, si data ta nisjes së tyre për në adresën postare të KQZ-së, kanë datat 19 shtator 2019 deri me datën 5 tetor 2019, sikurse 4,639 pakot me fletëvotime tashmë të vlerësuara dhe numëruara. KQZ njofton se, me datën 31.10.2019, është prezantuar Raporti njoftues për vlerësimin e pakove me fletëvotime, sipas Aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A.A-U.Zh.nr.20/2019, i datës 30.10.2019. Në këtë raport, ndër të tjerash, në mbledhjen e datës 31.10.2019, i mbajtur në ora 11:30, KQZ-ja është njoftuar se, Sekretariati, me datën 17.10.2019, ka tërhequr nga posta numër 6 në Prishtinë, 1,806 pako të supozuara me fletëvotime, dhe ka rekomanduar KQZ-në, që të marrë vendim për procedim të vlerësimit ose jo, të 1,806 pakot të supozuara me fletëvotime.

Paneli, në kuptim të nenit 3 paragrafi 8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, këtë ankesë e trajtojë si apel, duke konsideruar se në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat.

Paneli, në rishqyrtim pasi vlerësoi pretendimet e palëve në procedurë, provat që gjenden me shkresat e lëndës, gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: në mes të palëve në procedurë, në këtë rast nuk është kontestuese se 1806, pako me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosove, janë pranuar nga KQZ-ja me datë 17.10.2019, pas ditës së zgjedhjeve të datës 06.10.2019, po ashtu nuk është kontestuese se këto pako me fletëvotime janë dorëzuar nga votuesit jashtë Kosovës, përmes postës në shtetin ku jetojnë nga data 19.09.2019, e deri me datë 30.09.2019.

Kontestuese në këtë rast mbetet vetëm çështja e vlefshmërisë së këtyre pakove me fletëvotimeve, si të rregullta dhe të vlefshme, pasi që në KQZ, të njëjtat janë pranuar pas afatit të paraparë ligjor, për pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovë.

Paneli, konstaton se pretendimet e paraqitësit të apelit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, ngase KQZ-ja, drejt ka vepruar kur pakot me fletëvotime prej 1806, të

votuesve jashtë Kosovës, të cilat në KQZ, janë pranuar më datë 17.10.2019, që nuk i ka bartur në QNR, për procedim të rregullt dhe numërim sepse: Me nenin 96 paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcaktohet se: *“Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ- së”*, ndërsa me nenin 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, përcaktohet se: *Votat jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja, 24 orë para ditës së zgjedhjeve”*. Nga këto dispozita të lart cituara rezultojnë se paketat e fletëvotimeve të pranuar në kutinë postare 351, Posta nr.6, në Prishtinë e cila është hapur nga KQZ-ja, për pranimin e fletëvotimeve nga jashtë Vendit, andaj mbërritja e çdo pakete postare me fletëvotim, në këtë adresë brenda afateve të përcaktuara ligjore, konsiderohet e vlefshme, ndërsa fletëvotimet të cilat kanë arritur në këtë adresë, pas afatit të përcaktuar me nenin 96 parag.2 të LZP-së dhe nenit 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr.03/2013, siç është rasti me fletëvotimet për të cilat është ushtruar apeli, që janë pranuar pas ditës së zgjedhjeve, të datës 06.10.2019, janë të pranuar pas afatit ligjor, prandaj të njëjtat nuk mund të procedohen si fletëvotime të vlefshme.

Në kuptim të kësaj Paneli, vlerëson se në këtë rast Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është ligj material juridik dhe procedural i cili në mënyrë shprehimore dhe të qartë, ka përcaktuar afatin se kur paketat me fletëvotime duhet të arrijnë në KQZ, për t'u trajtuar si të vlefshme (ky afat është 24 orë, para ditës së zgjedhjeve siç përcaktohet me nenin 96 paragrafi 2 të LZP-së dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013), dhe se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me situata të pa përcaktuara më LZP-në dhe me Rregulla Zgjedhore, që mund të gjenin përshtatshmëri zbatim dispozitat e LPK-së.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është në përputhje me Konventën Evropiane për Të Drejtat e Njeriut, respektivisht me protokollet shtesë të saj, më konkretisht me nenin 3.3 të këtij protokoll shtesë, sepse ky protokoll parasheh obligime për shtetet që të sigurojnë mekanizma që iu mundësojnë qytetarëve të ushtrojnë të drejtën e tyre, për të zgjedhur apo për tu zgjedhur, ndërsa neni 96 i LZP-së, nuk e cenon një të drejtë të tillë, por e kufizon afatin e pranimit të fletëvotimit, dhe në këtë rast votuesit jashtë Kosove, kanë pasur afat të mjaftueshëm kohor, për të shfrytëzuar të drejtën e tyre të votës. Këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar mijëra votues të tjerë jashtë vendit, në afatet e përcaktuara me ligj dhe paketat me fletëvotime të njëjtëve, janë trajtuar të vlefshme.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është nxjerr në përputhje me praktikatat e mira të shteteve anëtare të BE-së, ku pjesa dërmuese e këtyre shteteve e kanë të përcaktuar se fletëvotimet duhet ta arrijnë para ditës së zgjedhjeve, ndërsa një pakicë e shteteve e kanë të rregulluara në atë mënyrë që fletëvotimet duhet të arrijnë deri në mbylljen e vendvotimeve në ditën e zgjedhjeve. Krejt kjo i kontribuon garantimit të integritetit të procesit zgjedhor, pasi pranimi i paketeve me fletëvotime, pas afatit ligjor të cekur më lartë e minon dhe cenon integritetin e procesit zgjedhor. Në këtë frymë janë edhe rekomandimet e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Kodi i Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore i miratuar me datë: 18-19 tetor 2002, të cilat parashohin: *“Votimi me postë do të zhvillohej nën një procedurë të veçantë disa ditë para zgjedhjeve”*.

Pranimi dhe trajtimi i paketeve me fletëvotime të arritura pas afatit, përveç cenimit të integritetit të procesit zgjedhor e fut KQZ-në, në një rreth vicioz nga i cili është problem të dilet, sepse kjo ia pamundëson KQZ-së, që në një afat optimal, të shpall rezultatin zgjedhor dhe nuk afatizon procesin e pranimit të paketeve me fletëvotime nga votuesit jashtë vendit. Kjo

bie në kundërshtim me qëllimin e ligdhënësit, pasi ligdhënësi ka pasur për qëllim që të caktoj afatin ligjor, brenda të cilit duhet të përmbyllet procesi i pranimit të pakove me fletëvotime, pasi në të kundërtën kjo do të shkonte në pafundësi të përmbylljes së këtij procesi zgjedhor.

Pretendimi i paraqitësit të apelit se në këtë rast me mos dërgimin në QNR, për tu numëruar këto fletëvotime, votuesve iu është cenuar apo mohuar e drejta për të zgjedhur sikurse garantohet me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar, për arsye se me asnjë veprim apo vendim KQZ-ja, nuk ua ka mohuar të njëjtëve të drejtën për të votuar, pasi që për ta shfrytëzuar të drejtën kushtetuese, për të votuar dhe zgjedhur janë përcaktuar rregullat se si mund të shfrytëzohet kjo e drejtë, siç është përcaktuar me nenin 96 paragrafi 2 i LZP-së, dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, të KQZ-së, çka do të thotë se të njëjtat duhet të arrijnë në KQZ, në afatin prej 24 orëve, para ditës së zgjedhjeve.

Paneli, me rastin e vendosjes, i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të paraqitësit të apelit, por këto pretendime janë vlerësuar si të paqëndrueshme dhe pa ndikim për të vendosur ndryshe, sepse në këtë rast nuk kemi të bëjmë me të drejta zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, por kemi të bëjmë me mosrespektim të afateve ligjore, të cilat afat janë prekluzive dhe nuk mund të ndryshohen apo të zgjatën, por vetëm zbatohen siç janë të përcaktuara me ligj.

Nga arsyet e theksuara me lart, e bazuar në nenin 115, 117, 118 dhe 122 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.381/2019 më datën 03.11.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.